

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shqetësimet e bankave, rritet perceptimi i rrezikut nga tregu i pronave dhe ai politik
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/shqetesimet-e-bankave-rritet-perceptimi-i-rrezikut-nga-tr-egu-i-pronav-i105948
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 05:31:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 05:17:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	442c8b97ac86210d1e0702156f1360b28632bfd04e0d68ecbd538cab92cce150
TEKSTI	8b784dc30cf3fce96eedf49627666fc6ca973bc96a92db8cddb669906d7d107c
PAMJA	8026be3cd0c1aa0be8d3665d75a5831d265b7288a8535992ee6bbc0638a05c70

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2d6ade1d04efc22141263fc1c2d6660b94de80d8e00c69259062262404302fcc
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b78e5a58bb99b6139c75653f203f708926b237e838138b6b7709d24a7b49499b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2d6ade1d04efc22141263fc1c2d6660b94de80d8e00c69259062262404302fcc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

paguajnë:
Të ardhurat
hën 5%

dobët në
buxhetin
e shtetit

suksesit

përparësit...

Kama
dhe Vlorë
Hvzeni

arrestimit të
ish-
drejtoreshës
e SHIS

BE po e
vëzhgon

së
Shqipërisë
(SHIS...

floku dhe...?

Policia
Shkencore,
ka

AKTUALITET

Shqetësimet e bankave, rritet perceptimi i rrezikut nga tregu i pronave dhe ai politik

Piranjat Përditësimi i fundit 25 Shtator 2026, 07:17



Rezultatet e vërtetimit mbi perceptimin e rreziqeve sistematike në vend nga sektori bankar tregojnë se, gjatë gjysmës së parë të vitit 2026, renditja e rreziqeve kryesore dhe nivelet e perceptimit të tyre kanë paraqitur ndryshime, me rritje të shqetësimit të lidhur me çmimet e pronave dhe të atij politik, pas valës disamujore të protestave ndaj qeverisë.

Transferimi i goditjeve nga ekonomia e jashtme vijon të konsiderohet si rreziku sistematik më i rëndësishëm nga bankat. Pas një zbutjeje të përkohshme në gjysmën e dytë të vitit 2025, vlerësimi për këtë rrezik është rritur përsëri gjatë gjatshëmujorit të parë të vitit 2026 nga niveli "mesatar" në "i lartë".

Kjo ecuri ka reflektuar pasiguritë e vazhdueshme në mjedisin ekonomik dhe gjeopolitik ndërkombëtar dhe potencialin e tyre për t'u transmetuar në ekonominë shqiptare.

Rreziku i lidhur me luhatjen e vlerës së pasurive të paluajtshme është klasifikuar si rreziku i dytë më i rëndësishëm sistematik i periudhës dhe vlerësimi për të është rritur duke kaluar nga niveli "i ulët", në "mesatar".

Rritja e vazhdueshme e çmimeve të pasurive të paluajtshme dhe ekspozimi i konsiderueshëm i sektorit bankar ndaj këtij tregu vazhdojnë ta mbajnë këtë rrezik në grupin e faktorëve që kërkojnë monitorim të vazhdueshëm.

Megjithatë intensiteti i perceptuar nga bankat nuk është i lartë, shqetësimi i tyre është në rritje, veçanërisht për ndikimin e mundshëm të një korrigjimi të çmimeve në vlerën e kolateralit dhe rrezikun e kredisë.

Përkeqësimi i ekonomisë së brendshme vijon të mbetet në grupin e rreziqeve më të rëndësishme sistematike në vend. Në perceptimin e bankave, vlerësimi për këtë rrezik është zbutur krahasuar me gjysmën e dytë të vitit 2025, por duke mbetur brenda nivelit "mesatar".

Rreziku nga sulmet kibernetike vijon të perceptohet si një nga rreziqet kryesore sistematike. Megjithatë, vlerësimi i sektorit bankar për rëndësinë e tij ka rënë gjatë gjysmës së parë të vitit 2026 krahasuar me dy periudhat paraardhëse, gjë që mund të lidhet me investimet dhe strategjitë e ndërmarrja nga bankat për të kufizuar këtë rrezik.

Pavarësisht kësaj, në kushtet e digjitalizimit gjithmonë e më të madh të shërbimeve financiare dhe kompleksitetit në rritje të kërcënimeve kibernetike, ky rrezik është bërë tashmë një nga sfidat kryesore të biznesit bankar.

Së fundi, perceptimi mbi rrezikun politik ka shënuar rritje krahasuar me gjysmën e dytë të vitit 2025, duke u përfshirë në listën e rreziqeve kryesore sistematike.

Rritja e këtij perceptimi mund të lidhet me shtimin e pasigurive rreth zhvillimeve politike dhe institucionale në vend, të cilat mund të ndikojnë në pritjet e agjentëve ekonomikë dhe në klimën e biznesit.

Megjithatë, në vlerësimin e bankave, rëndësia e këtij rreziku vlerësohet ende ndjeshëm më e ulët krahasuar me rreziqet e tjera të lartpërmendura.

Në terma të përgjithshëm, deri në fund të gjysmës së parë të vitit 2026, bankat vlerësojnë se mundësia e materializimit të një ose disa prej rreziqeve sistematike në horizontin afatshkurtër (deri në një vit) mbetet në nivelin mesatar, megjithëse ky perceptim është rritur lehtë krahasuar me gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025.

Për horizontin afatmesëm (1–3 vjet), perceptimi i bankave për materializimin e këtyre rreziqeve mbetet më i lartë se ai afatshkurtër dhe ka shënuar gjithashtu rritje gjatë periudhës.

Nga ana tjetër, gjendja e mirë financiare e sektorit bankar dhe niveli i lartë i likuiditetit vijojnë të mbështesin besimin e bankave në qëndrueshmërinë e sistemit financiar, i cili mbetet mbi nivelin mesatar dhe pothuajse i pandryshuar krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar./ Monitor

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 25 Shtator07:04

[Rikthimi i penaliteteve, bizneset nuk po fitojnë, apo nuk po paguajnë; Të ardhurat bien 5%](#)

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin janë zëri me ecurinë më të dobët në buxhetin e shtetit në tetë muajt e pa...

AKTUALITET 24 Shtator23:35

[Prova që fundosi shefin e Policisë Shkencore, dërgoi akt-ekspertimin e makinës që rrëmbeu biznesmenin!](#)

Një akt-ekspertimi për makinën “Land Rover Defender”, i kryer me kërkesë të SPAK nga Policia Shkencore, ka mbërit...

AKTUALITET 24 Shtator22:35

[Artan Hoxha tregon prapaskenat se si arriti Ergys Agasi të përdorte Kadastrën e AKSHI-n: Ja si u bë miliarder](#)

Gazetari Artan Hoxha ka komentuar zhvillimet e fundit rreth ish-drejtores së SHISH, Vlora Hyseni dhe Ergys Agasit, duke pretenduar se çështja n...

AKTUALITET 24 Shtator22:24

[“Ka rreguar papjekuri”, avokati për çështjen “Hyseni”: Të hetohet në SPAK për shpërdorim detyre](#)

Avokati Idajet Beqiri ka kritikuar SPAK në “Real Story” për mënyrën e veprimit ndaj dosjes së Ergys Agasit dhe lidhjen me i...

AKTUALITET 24 Shtator22:22

[“Do plasë skandali te Kadastra”, Peka: Këshilli i Rregullimit të Territorit është bastisur nga SPAK](#)

Ish-zëvendësministri i Brendshëm, Avenir Peka, ka paralajmëruar zhvillime të reja hetimore në lidhje me Kadastrën dhe Kë...

AKTUALITET 24 Shtator22:09

[Sherr mes Lalës dhe Rexhajt: Meriton të rrihesh siç të rrihte Buzhala, por s’i ndjy duart me ty](#)

Një përplasje e ashpër ka ndodhur në studion e “Opinion” mes analistit Albatros Rexhaj dhe gazetares Klodiana Lala. Debati u nd...

AKTUALITET 24 Shtator22:00

[Modeli i Seyhanit/ Si iu “falën” 100 milionë dollarë BKT-së me bekimin e Bankës së Shqipërisë](#)

Në fillim të vitit 2022, Bordi i Drejtorëve të Bankës Kombëtare Tregtare thirrri me urgjencë dhe në panik një mble...

AKTUALITET 24 Shtator21:56

[“Në hotel me agjentë serbë”, Lala i kthehet Vlora Hysenit: Zgjedhi njeriun e gabuar](#)

Gazetarja Klodiana Lala i është përgjigjur akuzës së ish-kreut të SHISH, Vlora Hyseni, e bërë sot nga dera e SPAK. Prete...

AKTUALITET 24 Shtator21:35

[Detaje nga seanca me dyer të mbyllura, ja çfarë deklaroi Vlora Hyseni në SPAK!](#)

Gazetarja Anila Hoxha ka sjellë detaje nga seanca me dyer të mbyllura ndaj ish-drejtoreshës së SHISH, Vlora Hyseni, e cila u paraqit në...

AKTUALITET 24 Shtator21:08

[Kush ia dërgoi Agasit aktin e ekspertimit të kriminalistikës për gjurmë gishti, fije floku dhe...?](#)

Një akt-ekspertimi për makinën “Land Rover Defender” i kryer me kërkesë të SPAK nga Policia Shkencore, ka mbërit...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 24 Shtator

[EMRAT/ 63-vjeçari i intubuar te Trauma. Çfarë n...](#)

Një ngjarje e rëndë e ndodhur më 16 shtator në Sarandë, e cila nuk ishte bërë publike më herët, ka përfun...

AKTUALITET 24 Shtator

[Atentati ndaj vëllait të Fabio Dushkut/ Aksioni...](#)

Policia greke ka zhvilluar një aksion në Selanik, ku ka arrestuar tre shtetas shqiptarë të dyshuar për përfshirje në një&eum...

AKTUALITET 24 Shtator

[EMRI/ Ra në gropën e ashensorit dhe vdiq, si u ...](#)

Altin Kokici, një 51-vjeçar me origjinë shqiptare, është gjetur i vdekur natën mes të mërkurës dhe të enjtes...

Nga Xhuljan Ferzaj INVESTIGIME 23 Shtator11:40

[EKSKLUZIVE/ Eskortat e huaja “mbysin” Tiranën: Si vajzat nga Brazili, Kolumbia e Vietnami ofrojnë shërbime sek*uale për 50-150 euro](#)

Prostitucioni me shtetase të huaja po shfaqet gjithnjë e më hapur në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Përmes...


video




PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.